



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë , Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40 në pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa , Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 02.02.2024 me nr. prot. 01Nr.401-3728/2024, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 13.02.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të rregullt të mbajtur më datën: 23.02.2024 , mori këtë :

V E N D I M

Për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake nga viti 2023 në vitin 2024

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024 në shumë prej **942,121.66 €**.

2. Shuma si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:

- Paga dhe Mëditje në shumën prej **45,000.00 €**;
- Mallra dhe Shërbime në shumën prej **65,000.00 €**;
- Shpenzimet Komunale në shumën prej **20,000.00 €**;
- Subvencione dhe Transfere në shumën prej **24,149.00 €**;
- Shpenzime Kapitale në shumën prej **787,972.66 €**.

2.1 Në kategorinë paga dhe mëditje :

Arsimi Fillor (93510), shuma prej **30,000.00 €**;

Arsimi Mesëm (94710), shuma prej **15,000.00 €**;

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera në mësimin për të rritur dhe obligime të zëvendësimit të mësimdhënësve të liruar nga puna për shkak të sëmundjeve të rënda.

2.2 Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej **65,000.00 €**;

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera në mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

2.3 Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej **10,000.00 €**;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej **10,000.00 €**.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të nxemjeve qendrore me pompa termike dhe rritja e tarifave për shërbimet e pastrimit.

2.4 Në kategorinë Subvencione dhe transfere :

Zyra e kryetarit (16018), shuma prej **24,149.00 €**;

- **Arsyetim:** Rritja e shpenzimeve për pagesat e lindjeve dhe varrimeve.

2.5 Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Bashkëfinancim me donatorë”, kod (48267), shuma prej 155,386.49 €;

“Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka”, kod (54272), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq”, kod (54276), shuma prej 3,186.17 €;

“Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dolc”, kod (54280), shuma prej 95,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gremnik”, kod (54292), shuma prej 4,900.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Jashanice-Jelloc-Resnik-Pogragje”, kod (54293), shuma prej 45,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Sferke-Volljake-Qupeve”, kod (54300), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjia Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe”, kod (54336), shuma prej 100,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gjurgjevik të Madhe”, kod (54337), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krusheve e Vogël (trotuari Kline-Zllakuqan)”, kod (54341), shuma prej 30,000.00 €

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Poterq-Dugajeve-Drenovc”, kod (54344), shuma prej 40,000.00 €;

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik Krushevë e Vogël- Madhe, Drenovc, Qeskovë, Jashanic, Leskoc, Ranoc”, kod (54353), shuma prej 52,000.00 €;

“Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujerave te zeza ne Zllakuqan, Jashanice, Shtarice, Gllareve, Radulloç”, kod (54516), shuma prej 87,500.00 €.

Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndërtimi i shtëpisë se pleqëve ne Kline”, kod (54463), shuma prej 100,000.00 €.

Arsimi Fillor (93510), në projektet:

“Rindërtimi i objektit shkollorë, Gjimnazi Luigj Gurakuqi”, kod (54380), shuma 15,000.00 €.

Arsyetim: Në vitin 2023 dhe në vijim inflacioni e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Mbulimi i obligimeve kontraktuale dhe vazhdimin e projekteve të pa përfunduara.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

4. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-6135 /2024
Klinë, më 28.02 /2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi